



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikës dhe Financa, mbajtur më 25.07.2018,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: **Agim Kuleta**, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: **Genc Sherifi**, **Vala Peshku**, **Halim Halimi**, **Agim Gashi**, **Sami Boroci**, **Jeta Rafuna**, **Eman Rrahmani**, **Fadil Gashi** dhe **Egzon Azemi**.
Mungoi: **Blerand Stavileci**.

Në mbledhje morën pjesë edhe: **Osman Bllaca**, përfaqësues i ekzekutivit, **Fatos Dibra**, përfaqësues i Zyrës ligjore, **Dren Kukaj**, drejtor i Drejtorisë së Pronës, **Yll Rugova**, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, **Lulzim Vrapca**, udhëheqës i Zyrës për komunitete dhe kthim, **Luaras Oseku** dhe **Faton Ajeti** përfaqësues nga OSBE-ja.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimin për rendin e ditës, kryesuesi propozoi që këto pika të rendit të ditës dhe materialet tjera që duhet të përfshihen, të ndahen në dy seanca, sipas prioriteteve, duke shtuar edhe pika të tjera.

Agim Gashi kërkoi që edhe materialet të tjera të futen si pika të rendit të ditës, siç janë: "Raporti 6-mujor financiar", "Raporti i auditimit" dhe "Plani i punës së Kuvendit".

Halim Halimi shprehu mendimin se ky takim i Komitetit për Politike e Financa është dashur të mbahet më herët, dhe është dashur të përfshihen edhe: "Plani i punës së Kuvendit" dhe "Raporti 6-mujor financiar", edhe pse nuk e kemi komisionin për vlerësimin e patundshmërisë.

Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se raporti 6-mujor do të jetë për mbledhjen e ardhshme, ndërsa Plani i punës së Kuvendit është miratuar në seancën e kaluar.

Sami Boroci propozoi që këto pika të ndahen në dy seanca.

Lulzim Vrapca propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës për seancën e ardhshme "Propozimvendimi për miratimin e Planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Prishtinës, 2018 - 2021".

Agim Kuleta, kryesues, sa i përket Rregullores së punës së Kuvendit, bëri të ditur se duhet ndërruar Statutin e Komunës në përputhje me Ligjin e ri të Prishtinës.

Ai shprehu mendimin se grupit punues që është caktuar duhet zgjeruar kompetencat edhe për Statutin. Njëherësh propozoi që të futet si pikë e rendit të ditës: "Zgjerimi i kompetencave të grupit punues për Statutin e Komunës së Prishtinës".

Eman Rrahmani propozoi formimin e komisionit për vlerësimin e pronave.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, me pikat që janë në rend dite dhe me propozimet të cilat shkojnë.

Njëzëri u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes urgjente dhe mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2017 në vitin 2018;
3. Propozimvendimi për emërtimin e stadiumit të futbollit të Prishtinës "Fadil Vokrri";
4. Propozimrregullorja për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës;
5. Propozimrregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës;
6. Propozimrregullorja për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale;
7. Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës;
8. Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës;
9. Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ;
10. Propozimvendimi për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Herticëve";
11. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Trio Construction";
12. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "AL Trade";
13. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për "Motrat e Shën Kryqit";
14. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Feti Selmani";
15. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes urgjente dhe mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes urgjente dhe mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2017 në vitin 2018;

Agim Gashi i parashtrroi pyetje për Zyrën ligjore lidhur me këtë pikë. Çka do të thotë vonesa 8-mujore e miratimit të bartjes së buxhetit për drejtorin e Drejtorisë së Financave? Nëse ka përfaqësues, është dashur ne para se ta miratojmë, me pasur një informatë se sa mjete janë shpenzuar prej 1 janarit deri tani nga kjo vlerë e bartjes.

Ai kërkoi të kompletohen me material të saktë.

Fatos Dibra dha sqarime, duke cekur se në aspektin e pagesave nuk ka njohuri, ndërsa në aspektin ligjor, nuk është e përcaktuar koha deri kur duhet të bëhet bartja.

Eman Rrahmani tha se në E-mailin që na është dërguar informata për mbledhje, na është premtuar se do të silllet materiali edhe për këtë pikë, mirëpo nuk na ka ardhur, andaj është mirë që të tërhiqet kjo pikë meqë nuk kemi material.

Agim Kuleta, kryesues, u shpreh se nëse materiali arrin të dërgohet për mbledhje të Kuvendit është në rregull, nëse nuk arrin, atëherë tërhiqet kjo pikë.

Agim Gashi tha se ne e votojmë me plotësimin për informacion shtesë për pikat që u parashtruan.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetjake nga viti 2017 në vitin 2018, me kërkesë për informata shtesë për Kuvend, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për emërtimin e stadiumit të futbollit të Prishtinës "Fadil Vokrri".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për emërtimin e stadiumit të futbollit të Prishtinës "Fadil Vokrri" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimrregullorja për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës.

Osman Bllaca dha sqarime lidhur me këtë pikë.

Agim Gashi tha në nenin 14 thotë: “Komuna mund të ndajë subvencione për arsim, duke përfshirë pika f), gara dhe kuize (aktivitete jashtëmësimore)”, kjo shprehje nuk është adekuate me qëllimin që ka, andaj të shikohet se mund të thuhet “aktivitete jashtë programit shkollor”. Në nenin 15, pika c), kategoritë e dala nga lufta (vetëm për studentë), kjo pikë duhet të plotësohet, duhet me qenë edhe nxënësit, mos me i përjashtuar nxënësit. Edhe neni 20, duhet me u shqyrtuar te pika d), dëshmi për pagesën e taksave komunale. Taksat për mbeturina, mendoj asnjë kod juridik nuk mund të kushtëzohet, nuk mund t’ia kushtëzojë qytetarit, ka mekanizma të tjerë, është shkelje e të drejtave të njeriut.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimrregullorja për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prishtinës, me propozimet për ndryshime, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimrregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës.

Agim Gashi ceku se në nenin 9.4 thuhet: “Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit të tapës, përveç mobileve ... më poshtë thuhet prodhimi i mobileve, e përdor dy herë, diku e hiq, brenda një neni, e diku e shton, andaj të shikohet se çka ka dashur me thënë në të parën dhe të dytën.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimrregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste në komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Propozimrregullorja për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimrregullorja për caktimin e vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale dhe dërgohen në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës.

Yll Rugova dha sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Agim Gashi tha se po ndërlidhem me statutin si dokument, neni 4, pika 5, me dhënë sqarime më të hollësishme për degët e Muzeut, po ashtu te neni 10, pika 4 thotë: "Këshillin drejtues të MP -së e emëron dhe e shkarkon DK-ja". Këshillat drejtues janë organe përfaqësuese, që përfaqësojnë disa nivele institucionale, andaj kisha sugjerua të shqyrtohet kjo pikë, në mënyrë që t'ia leni të drejtën Muzeut të Prishtinës, që t'i përcaktojë vetë përfaqësuesit e vetë.

Yll Rugova dha sqarime lidhur me çështjet që i ceku z. Gashi, duke u përgjigjur se për çështjen e parë që u ngrit, ne i kemi ndjekur shembujt e disa komunave të tjera që kanë përvojë më shumë në këtë drejtim.

Vala Peshku theksoi se logoja zakonisht e ka shenjën e identifikimit, se nëse kemi katër muze të ndryshme, secila prej logove ka për ta identifikuar muzeun si muze, çka prezanton ai muze.

Egzon Azemi pyeti z. Rugova lidhur me çështjen e një ankese, të cilën e kishte marr një ditë më parë nga një qytetar, rreth shkollave të Herticët, ku një prej banorëve thotë se është përfshirë vetëm shkolla ku ka qenë gjimnazi e jo edhe shkollat tjera.

Yll Rugova u përgjigj, duke thënë se këta e kanë dhënë shtëpinë donacion për Muze. Nëse është dikush i interesuar të japë shtëpinë-shkollë për muze, ne jemi të gatshëm t'i përfshijmë edhe ata.

Agim Gashi tha se këto nuk duhet quajtur shkolla të Herticëve, se nuk janë shkolla të Herticëve, por janë publike, objektet ishin të Herticëve.

Yll Rugova, sa i përket nenit 10, pika 4, për këshillin drejtues, bëri të ditur se janë duke e ndjekur modelin ashtu si e ka Ministria e Kulturës.

Agim Kuleta, kryesues, tha se te neni 10, pika 4, ku thotë se Këshillin drejtues të MP-së e emëron dhe e shkarkon DKRS-ja, këtu duhet të përmirësohet, jo DKRS -ja, por Drejtoria e Kulturës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Projektstatuti i Muzeut të Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës.

Yll Rugova dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se janë shumë hapësira kulturore që janë të Komunës së Prishtinës e që po menaxhohen nga OJQ-të, andaj ne duam të themelojmë një institucion kulturor, të quajtur Qendra Kulturore e Prishtinës, përmes së cilës ne i menaxhojmë qendrat tona kulturore, por edhe hapësirat tjera kulturore, e pastaj u jepen palëve.

Eman Rrahmani tha se ky është vetëm krijimi i institucionit kulturor, nuk është me dhënë prona.

Sami Boroci theksoi se kjo po i bie që Qendra Kulturore me i propozuar Kuvendit, e Kuvendi me miratuar një dhënie.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ.

Agim Kuleta, kryesues, theksoi se ne këtu nuk jemi për t'i ndarë vendet e Komitetit konsultativ sa i përket qytetarëve, shoqërisë civile, por ne duhet bërë panelin përzgjedhës, do të shpallet konkursi për formimin e Komitetit konsultativ, që përbëhet prej qytetarëve. Në këtë komitet nuk do të ketë anëtarë të Kuvendit.

Agim Gashi kërkoi sqarime, pasi që aty thuhet "Vendimi për themelimin e Komitetit konsultativ".

Agim Kuleta, kryesues, sqaroi, duke thënë se neni 4 i parasheh procedurat si themelohet ky komitet, duhet zgjedhur paneli përzgjedhës, i caktuar nga Kuvendi i Komunës.

Sami Boroci tha se është mirë të dakordohemi këtu e të shkojmë me propozime në Kuvend.

Agim Kuleta, kryesues, kërkoi që kjo të shkojë në Kuvend dhe grupet parlamentare ta propozojnë nga një person dhe del në votim, e finalizojmë punën në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për themelimin e Komitetit konsultativ dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Herticëve".

Yll Rugova dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se kjo është pjesë e marrëveshjes me familjen Aliu për çështjen e pronës së tyre, të cilën ata po e japin për Komunë të Prishtinës për Muze, ku një prej kushteve të tyre ke qenë me ndërruar këtë emër.

Agim Gashi tha se Kuvendi i ndërron emrat e rrugëve.

Sami Boroci shtroi pyetje për Zyrën ligjore, duke thënë se unë kam pranuar shumë kërkesa për ndërrime të emrave, andaj po më intereson se a ka ndonjë formë juridike për të shqyrtuar ndërrimin e emrit të ndonjë rruge, apo duhet shkuar vetëm përmes listës rezervë të emrave të rrugëve?

Fatos Dibra dha sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar.

Sami Boroci pyeti se a ka hapësirë me futur në listën rezervë emër të ri.

Eman Rrahmani theksoi se është një problem lidhur me këtë. Si Kuvend, nuk guxojmë të futemi në ndërrimin e emrave të rrugëve, përveç rasteve të veçanta, siç është ky që është për interes publik, sepse kemi shumë kërkesa, vetëm unë i kam 20-30 kërkesa që më janë drejtuar për ndërrime të emrave të rrugëve.

Agim Kuleta, kryesues, tha se kjo mund të trajtohet, ka arsyetim të veçantë, se lidhet me këtë projektin tjetër. Mua po më intereson çështja e procedurave. Tani ky komision nuk ekziston më, meqë nuk ekziston, a ka ndonjë mundësi që këtë ta bëjë Kuvendi?

Agim Gashi propozoi të thirret rruga "Shkolla te Herticët".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për ndërrimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Herticëve" dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Trio Construction".

Dren Kukaj dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se për Kuvend do ta keni materialin me të dhëna të sakta, se prej gjeodetëve kam kërkuar të dhënat për pronat që treten, si për pronën komunale dhe pronën private, numrin e parcelave, sipërfaqen totale të parcelës të lagjes apo fshatit ku gjendet me parcelë dhe sipërfaqe që këmbehen, ortofoton, skicën etj. që ju ndihmon.

Agim Gashi kërkoi që mundësisht të jenë edhe emrat e rrugëve.

Sami Boroci shtroi pyetje. Në njërën prej pikave ka qenë një kontest më herët, kur e keni shkëmbyer një pronë me "Al Trade", andaj a ka ndonjë mundësie që ne para se me votuar, me identifikuar se nuk ka konflikt interesi.

Dren Kukaj dhe **Fatos Dibra** dhanë sqarime lidhur me pyetjen e parashtruar.

Agim Gashi bëri pyetje, duke thënë se në Ligjin mbi pronën, në një nen thotë: "Në çdo procedurë këmbimi komuna duhet ta ruajë vlerën e pronës", po më intereson se a bëhet vlerësimi pas miratimit në Kuvend, apo para miratimit në Kuvend. Ne e miratojmë këtë parcelë dhe kur e bën vlerësimin Ministria, a ka ndodhur ndonjëherë me thënë se ju i keni dhënë më shumë se ai që ju ka dhënë juve?

Dren Kukaj tha jo, kurrë, ligji është i vetmi organ që mundet drejt me vlerësuar.

Agim Gashi theksoi se i njëjti ligj e shpjegon çështjen se si komuna mund të kthejë prona nga AKP-ja, andaj a ka bërë kërkesë Komuna e Prishtinës për pronat që i ka AKP-ja në dispozicion? P.sh. AKP-ja ka prona në Veternik dhe ne kemi nevojë për një pronë private atje, në qoftë se AKP-ja ia njih Komunës të drejtën e asaj prone që e ka në dispozicion, atëherë ne pastaj e kemi lehtë me bërë këmbim me pronarin e pronës.

Dren Kukaj dha sqarime lidhur me çështjen e parashtruar nga Agimi.

Eman Rrahmani tha se janë dy prona që janë për këmbim, prona 10207-2 këmbehet me pronën 2759-9, kurse prona 10207-3 bëhet kompensim me koeficient ndërtimi të parcelës kadastrale, andaj kërkoj sqarim për këtë çështje.

Dren Kukaj dha **Fatos Dibra** dhanë sqarime lidhur me çështjen e parashtruar.

Eman Rrahmani kërkoj shpjegim se si ka mundësi prona komunale me u shkëmbyer me koeficient ndërtimi.

Fatos Dibra dha sqarime për këtë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua **Propozimvendimi** për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Trio Construction" dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "AL - Trade".

Dren Kukaj dha sqarime lidhur me këtë pikë, duke cekur se kjo është në kuadër të nevojës së ndërtimit të shkollës në Veternik dhe dështimit të këmbimit të mëhershëm. Ky është një këmbim më i hershëm që ka dështuar, sepse ka munguar pëlqimi i palëve. Tani e kemi vendimin me prona që merren në Veternik dhe tokat që jepen nëpër vende të ndryshme në Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua **Propozimvendimi** për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "AL Trade" dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për "Motrat e Shën Kryqit".

Fatos Dibra tha se ky nuk është këmbim, por është dhënie e pronës në shfrytëzim, është një përmirësim i një vendimi të mëhershëm, është Plotësim-ndryshim i Vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për "Motrat e Shën Kryqit".

Dren Kukaj dha sqarime lidhur me këtë pikë.

Eman Rrahmani pyeti se sipërfaqja e parcelës nr. 2791-0, e cila nuk ekziston, ku është marrë?

Fatos Dibra tha se është gabim teknik, por për Kuvend do të përmirësohet, duhet të jetë sipërfaqja e parcelës nr. 2791-1.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për "Motrat e Shën Kryqit" dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Feti Selmani".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private "Feti Selmani" dhe dërgohet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

